



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN130720220006

Tiranë, më: 22.08.2022

Komisioni 48

DEKLARATË MJEDISORE

Në zbatim të Ligjit nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri.

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (Sh.a KESH)”

Nr. NIPT-i: J61817005F

Adresa e selisë: Blloku ‘Vasil Shanto’, Rruga “Viktor Eftimiu”, Tiranë.

Për të zhvilluar projektin **“IMPIANTI TERMIK LUNDRUES I PËRKOHSHËM, NE VLORË, SHQIPËRI”**

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Industria e energjisë, Instalime industriale për mbajtjen e gazit, avullit ose ujit të ngrohtë; transmetimin e energjisë elektrike me kabëll në lartësi.

Vendndodhja: Triport, Vlorë

Të dhëna teknike:

Kapacitet i instaluar 110 MW

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen: Të merret mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura për statusin mjedisor të zonës (kategoria 4-të). o Sugjerojme që gjatë implementimit të projektit, mbetjet e gjeneruara të menaxhohen sipas kuadrit ligjor si më poshtë: - Vendim i Këshillit të Ministrave nr.575, date 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”; - VKM nr.177, datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”; - VKM nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, i ndryshuar; - VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”; - VKM nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”; - VKM nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë akumulatorët dhe mbetjet e tyre”; - VKM nr. 127, datë 11.02.2015 “Kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura”; - VKM nr.957, datë 19.12.2012“Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”; - VKM nr.1032, datë 16.12.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.371, datë 11.06.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre” ; - VKM nr.1031, datë 16.12.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 229, datë 23.04.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”; - VKM nr.402, date 30.06.2021 “Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve”; VKM Nr. 538, datë 22.9.2021 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 687, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”; - VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”; - VKM nr.687, date 29.7.2015 “Per miratimin e rregullave per mbajtjen, perditësimin dhe publikimin e statistikave te mbetjeve”; - VKM nr.418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve,2020-2035”; - Ligji nr 10463, datë. 22/09/2011 “Për Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve” i ndryshuar; - Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar; - Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar; - Ligji nr. 41/2017, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura”. o Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së shfrytëzimit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme: - Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”; - Të spërkatën rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”; - Lënda djegëse që do të përdoret të jetë në përputhje me VKM-në nr. 429, datë 26.6.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, si dhe VKM-në nr.147, datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diesel”. o Me qëllim mbajtjen nën kontroll dhe reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe përbërësve organikë të avullueshëm (VOC-ve), të mbahen në konsideratë: -

Parashikimet e Ligjit 155/2020 “Per ndryshimet klimatike”; - Parashikimet e VKM-së nr. 907, datë 21.12.2016 “Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve”; - Parashikimet e VKM-së nr. 909, datë 21.12.2016 “Për rikuperimin e avujve të benzinës në fazën e dytë, gjatë mbushjes së mjeteve motorike në stacionet e shitjes së karburanteve”; - Parashikimet e VKM-së nr. 908, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e masave për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalim”; - Parashikimet e VKM-së nr.1075, datë 23.12.2015 “Për masat për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC), që rezultojnë nga magazinimi dhe shpërndarja e benzinës nga terminalët në stacionet e shitjes së karburanteve”. Me qëllim respektimit e detyrimeve ligjore të sipërcituarra, të sigurohet dhe kryhet monitorimi i vazhdueshëm i shkarkimeve në ajër të treguesve të cilësisë së ajrit. Sugjerohet që si gjatë fazës së ngritjes së infrastrukturës ndihmëse të këtij impianti ashtu edhe gjatë funksionimit të tij, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme: - Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Menaxhimi i kimikateve”; - Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, duhet të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, si dhe VKM-së nr. 9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”); - Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, duhet të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Menaxhimi i kimikateve”; - Bazuar në raportin e VNM-së, ky impiant termik parashikohet të funksionojë nëpërmjet djegies së karburantit dhe mazutit/solar (vaj i rëndë karburanti, HFO), i cili është i kontaminuar me disa përbërës të ndryshëm duke përfshirë aromatikë, squfur dhe azot, që e bëjnë emetimin pas djegies më ndotës në krahasim me vajrat e tjerë të karburantit. Në këtë kuadër duhet të mbahen në konsideratë parashikimet e VKM-së nr. 319/2019 “Për kufizimet për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm”. o Sugjerojmë që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit t’i përmbahet legjislacionit në fuqi në lidhje me zhurmat. o Sugjerojmë verifikimin nga ana juaj të vlefshmërisë së procesit të realizuar të konsultimit me publikun mbi respektimin e parashikimeve në VKM nr.247 datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore” në lidhje me afatet ligjore dhe përcaktimet e tjera. Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr.10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve etj., të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombetare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Sipërfaqja bazuar në koordinatat e aplikimit ku do të zhvillohet projekti “Instalime industrial për mbajtjen e gazit, avullit ose ujit të ngrohtë; transmetimin e energjisë elektrike me kabëll në lartësi”, me zhvillues Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), dhe aplikues Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), me nr. Aplikimi AN120420220003, referuar Vendimit të KKT-së nr. 10, datë 28.12.2020 shtrihet jashtë zonës së mbrojtur të PM Pishë PoroNartë, në kufi të tij.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore: Në përgjigje të kërkesës suaj mbi aplikimin për VNM-në e thelluar të aplikantit “KESH” sh.a. me zhvillues projekti “KESH” sh.a. me të dhënat: Nr.

AN120420220003, të datës 12.04.2022, ju sqarojmë se: Pas mbarimit të procedurave për VNM-në e thelluar, shoqëria “KESH” sh.a. duhet të aplikojë në portalin on-line të e-albania “Aplikim për përdorim burim ujor” për t’u pajisur me leje bazuar në ligjin Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të ndryshuar si dhe VKMsë nr. 550, datë 15.7.2020

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë: Verifikimi në objekt për inspektimin e subjektit nga specialistët e Lejeve dhe VNM-ve për dhënien e mendimit për VNM u mbështet në Ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjin Nr.10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Vendimin numër 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjegjësisive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe akteve nënligjore mjedisore në fuqi, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë ngriti grupin e punës më datë 19.08.2022 për Subjektin: “KESH” Sh.a me Aktivitet: “Impianti termik lundruer i përkohshëm në Vlorë, Shqipëri” me Vendndodhje: Zona e Triportit Vlorë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Vlorë. Subjekti “KESH” Sh.a nëpërmjet këtij projekti propozon vendosjen në zonën e Triportit e 2 anijeve ku janë instaluar gjeneruesit termikë të energjisë. Qëllimi kryesor është përballimi i situatës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike. Gjendja ekzistuese e zonës paraqitet pa problematika evidente. Sugjerime: • Në fazën e ndërtimit, mbetjet inerte të ripërdoren kur është e mundur ose të largohen rregullisht nga sheshi i ndërtimit duke u depozituar në pikat e caktuara nga Bashkia Vlorë si dhe të trajtohen sipas kërkesave të VKM Nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”. • Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujor dhe atë tokësor. • Në të gjitha rastet që do të ketë ndërhyrje në mjedisin tokë do të duhet të ruhet vegjetacioni si edhe bimësia karakteristike zonale duke mos dëmtuar në asnjë rast peizazhin natyror të zonës së marrë në studim. • Të kryhet rrethimi i kantierit të ndërtimit gjatë punimeve dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit. • Gjatë transportit të përdoren mushamatë e kamionave për të shmangur përhapjen e dherave e të materialeve inerteve në rrugët lidhëse të zonës. • Të merren masa për të zvogëluar ose zbutur efektet e zhurmës dhe dridhjeve aty ku ato janë praktike dhe me kosto efektive. • Të merren masat për lagjen e rrugëve të aksesit në kantier të cilat do të përdoren nga mjetet e tonazhit të lartë duke ulur mundësinë e përhapjes së grimcave të ngurta në mjedis. • Të bëhet sistemimi, rehabilitimi i sheshit të ndërtimit dhe të krijohen sipërfaqe të gjelbërta rreth objektit pasi ky i fundit të ketë përfunduar procesin ndërtimor sipas Lejes Zhvillimore. • Në rast se do të kemi dëmtim të habitateve të merren masa për rehabilitimin e tij ose zëvendësimin me habitat të ri. • Të merren masa për zbutjen e ndikimit në peizazh duke ruajtur natyralitetin e zonës. • Të përdorin alternativa ndaj motorëve me naftë/benzinë dhe njësive pneumatike, të tilla si njësitë hidraulike ose elektrike të kontrolluara, aty ku është e mundur dhe e arsyeshme. • Të kryhet monitorimi i rregullt i zhurmave pranë termocentralit dhe afër receptorëve më të afërt dhe të zbatohen nivelet kufi të zhurmës referuar Udhëzimit Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”. • Të përgatis udhëzimet dhe procedurat për veprim të menjëhershëm pastrimi pas çdo derdhje të naftës, karburantit apo kimikateve të ndryshme të cilat mund të jenë të pranishme në kantier. Të bëjë në mënyrë të vazhdueshme përmirësime teknologjike dhe të mirëmbajë impiantet termike. Të gjithë hidrokarburet, lëndët djegëse, lubrifikantët dhe kimikatet që do të përdoren të ruhen në rezervuarët e magazinimit të naftës të mbyllur dhe hermetikë, me pajisje specifike për të mbajtur këto sasi brenda rrethimeve të tyre. • Të sigurohet që serbatorët dhe komponentët e magazinimit të naftës të përmbushin standardet ndërkombëtare për dizajnin dhe integritetin strukturor dhe të sigurojnë mbrojtje ndaj korrozionit. Të kryhen inspektime periodike për korrozionin dhe integritetin e tankeve/rezervuarve, tubave dhe komponentëve të magazinimit, mirëmbajtje e rregullt e tubave, lidhësve dhe valvulave dhe komponentëve të tjerë. Tanket duhet të pajisen me pajisje

kontrolli në rast të mbingarkesave apo çarjeve të ndryshme • Ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura urbanë drejtpërdrejt në trupat ujorë pa trajtim paraprak. • Të gjitha mbetjet e lëngshme duhet të pajtohen me standardet dhe rregulloret në Shqipëri për cilësinë, temperaturën dhe aromën përpara se të shkarkohen në mjedis, përfshirë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë 31 Mars 2005 “Mbi Normat e Shkarkimit të Ujërave të Ndotur”. • Të respektohen parimet e legjislacionit në fuqi lidhur me zonat e mbrojtura, Ligji Nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”. • Të mbrojtë mjedisin tokë/ujë/ajër.

Bashkia Vlorë: Referuar aplikimit AN130720220006 në sistemin e-leje, i subjektit “Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare” sh.a, për aktivitetin “Projekti i impiantit termik lundruer i përkohshëm në Vlorë, Shqipëri”, në bazë të ligjit 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” të ndryshuar, duhet të pajiset me Deklaratë Mjedisore për VNM të Thelluar.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- VKM nr.163, datë 17.3.2021 “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË TË PORTIT TË PESHKIMIT NË TRIPORT, VLORË”;
- Në mendimin sugjerues të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Fier, Vlorë, Gjirokastrë;
- Në mendimin sugjerues të Bashkisë Vlorë;
- Në mendimet e anëtarëve të Komisionit nr. 48, datë 22.08.2022, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.106, datë 19.05.2022, “Një ndryshim në Urdhërin nr.75, datë 13.04.2022, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme

- 4.1** Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plote me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Pushteti Vendor) dhe akteve ligjore në fuqi.
- 4.2** Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Kreu I, Neni 1, Pika A); Kreu II, Neni 7, Pika 1; Kreu V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3** Ky vendim është i vlefshëm vetëm për aktivitetin e përkohshëm sipas titullit të instalimit. Ndalohet kategorikisht hyrja dhe qëndrimi i mejeve të tjera apo kryerja e veprimtarive jashtë kërkesave të parashikuara në aplikim.

- 4.4** Masa e dheut të gjeneruar nga operacionet e gjermimit, të sistemohet në një vend të caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
- 4.5** Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 4.6** Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
- 4.7** Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pa autorizuara
- 4.8** Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 4.9** Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.10** Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktuara nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.11** Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujor dhe atë tokësor.
- 4.12** Të bëhet kujdes me ruajtjen e ekosistemit ujor, duke mos cënuar në asnjë mënyrë segmentet ujor.
- 4.13** Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.14** Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 4.15** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.16** Furnizimin me energji elektrike të bëhet conform kërkesave e me miratimin të organeve kompetente.
- 4.17** Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacione DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e populates që preket nga kyaksident.
- 4.18** Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 4.19** Të kryhet mirëmbajtja në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur njei mazh të këndshëm dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
- 4.20** Të evitohet turbullimi i ujit që ndikon drejtëpërdrejtë në ciklet biologjike të mjedisit ujor.
- 4.21** Në rast se gjatë fazes së instalimit, projekti ka nevojë për vepra të tjera në shërbim të tij (venddepozitime, rrugë etj.), subjekti duhet t’i nënshtrohet procedurave të VNM-së sipas legjisllacionit në fuqi.
- 4.22** Kompania duhet të respektojë të gjitha kushtet teknike të ndërtimit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
- 4.23** Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh Ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.24** Në rast se do të mbyllet aktiviteti, të rehabilitohet mjedisi në përdorim, në bashkëpunim me pushtetin vendor.
- 4.25** në përfundim të instalimit sipas periudhës së përcaktuar në raportin Teknik 6-mujore të vlerësohet gjendja mjedisore.
- 4.26** Në përfundim të afatit 24 mujor të funksionimit të bëhet një raport mbi gjendjen e mjedisit për ndotjen e mundshme në mjedisin ujor, tokësor dhe në ajër.

- 4.27 Një nga masat kryesore zbutëse që mund të përdoret për të mbrojtur zogjtë nga përplasja me linjat ajrore është përdorimi i shënjesve të linjës (devijuesit) për të rritur shikueshmërinë e tyre.
- 4.28 Të gjitha dherat e gjeneruara gjatë fazës së germimit si dhe vegjetacioni e humusi pas pastrimit të kanalit të kullimit do të duhet të menaxhohen me teknikat më të mira të disponueshme nga subjekti zhvillues.
- 4.29 Të gjitha veprat hidrike si hidrovore, ura, argjinatura do të duhet të ruhen me prioritet sipas pritshmërisë së qëllimit final të projektit.
- 4.30 Të punohet me orare të reduktuara gjatë shtrimit të linjës së transmetimit të tensionit të lartë në zonat e urbanizuara për shkak të nivelit të zhurmave dhe shtimit të trafikut.
- 4.31 Subjekti zhvillues gjatë fazës së punimeve do të duhet të kujdeset për vendosjen dhe respektimin e sinjalistikave të duhura rrugore sipas legjislacionit vendas, në aspektin e sigurisë së lëvizjes së njerëzve, mjeteve motorrike si kamionë, autovetura mjete agrobujqësore.
- 4.32 Çdo objekt banimi/shërbimi dhe pronat ku kalon linja e interkonjeksionit do të duhet të shpronësohen sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.33 Nëse gjatë fazës së kryerjes së punimeve do të zbulohen gjetje arkeologjike do të duhet të njoftohen menjëherë autoritetet përgjegjëse dhe të ndërpriten punimet.
- 4.34 Të respektohet distanca dhe mos të çënohet Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta
- 4.35 Të respektohen parimet e legjislacionit në fuqi lidhur me zonat e mbrojtura, Ligji Nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.
- 4.36 Të rehabilitohet sheshi i zonës së zhvillimit të projektit në përfundim të jetëgjatësisë së tij.
- 4.37 Zhvilluesi duhet të ketë në vëmendje të vecante respektimin e Ligjit Nr. 131/2014 “Për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, në rast se do të preken toka bujqësore nga zhvillimi i projektit.
- 4.38 Gjate instalimit dhe funksionimit të aktivitetit, të mbahet parasysh LIGJI Nr. 111/2012 PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE
- 4.39 Të hartohet plani i masave që do të merren me qëllim ruajtjen e karakteristikave të mikroklimës së zones, e cila mund të çënohet nga zhvillimi i aktivitetit.
- 4.40 Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit 1982, dhe kështu që ka detyrimin të mbrojtë dhe të ruajë mjedisin detar ndaj Ndotjes VENDIM Nr. 177, datë 31.3.2005 PËR NORMAT E LEJUARA TË SHKARKIMEVE TË LENGËTA DHE KRITERET E ZONIMIT TË MJEDISEVE UJORE PRITËSE.
- 4.41 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

Veprimet e ndaluara (për ujrat e mbetjet)

- Shkarkimi në tokë, në mjedisin detar ose në ujra siperfaqësorë të ndotur, të grumbulluara nga anijet.
- Trajtimi e pastrimi i ujërave të ndotur jashtë vendeve të caktuara për këtë qëllim dhe nga personat fizikë ose juridikë, të palicensuar për këto veprimtari.
- Depozitimi i mbetjeve jashtë vendeve të caktuar e diegia e tyre në mjedis.
- Shkarkimi, hedhja në tokë ose në ujrat siperfaqësore i mbetjeve që cojnë në degradimin e vetive të tokës ose të ujërave siperfaqësorë dhe shkaktojnë rrezik ose dëm për shëndetin dhe mjedisin.
- Hedhja e lëndëve dhe e mbetjeve të rrezikshme helmuese e plasëse;
- Hedhja e substancave dhe e lëndëve të rrezikshme;
- Derdhja e hidrokarbureve dhe e ujërave të ndotura;
- Hedhja e lëndëve dhe e materialeve të ngurta, të çfarëdo natyre dhe lloji
- Hedhja e mbeturinave dhe e çdo lloj lënde nga anijet, platformat, instalimet dhe nga bregdeti; ë) fundosja dhe braktisja e çdo instalimi që ka shërbyer për veprimtari të ndryshme; f) ndërtimi dhe

vënia në funksionim e pajisjeve që lëshojnë rrezatim jonizues; g) djegia e lëndëve dhe e materialeve të çdo lloji jashtë vendit të punës;

Sanksionet e mundshme:

- Për mosrespektimin e kushteve të vendimit/legjislacionit kuadër për mbrojtjen e mjedisit, ka sanksione administrative e penale.
- Në bazë të Ligjit Nr. 10 440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Kreu VIII, Neni 26 ‘Sanksionet’, Pika 1. Zhvilluesi ngarkohet me përgjegjësi ligjore, sipas legjislacionit në fuqi, për pavërtetësinë e fakteve, të të dhënave të paraqitura dhe të dokumenteve që shoqërojnë kërkesën e paraqitur prej tij.
- dëmtimin ose shkatërrimin e zonave të shumimit ose të vendeve të qëndrimit, për këto specie.

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

Raportimi i të dhënave mjedisore:

- Në zbatim të kërkesave ligjore subjekti duhet të bëjë vlerësimin mjedisor periodik të veprës gjatë fazës së instalimit;
- Për të mbajtur informacionin mbi monitorimin, zbatimin e kushteve, subjekti duhet të përpilojë një regjistër të veçantë.
- Të dhënat e vetëmonitorimit dhe të zbatimit të kushteve të Vendimit duhet ta vërë në dispozicion të institucioneve shtetërore, si dhe të interesuarve të tjerë.
- Për çdo ndryshim të planifikuar në teknologji, operacione të paparashikuara dhe deklaruar në raportin e paraprak të VNM-së, të njoftohet menjëherë DRM-në e qarkut përkatës/AKM.
- Të njoftohet ARM-ja e qarkut përkatës, në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis.
- Gjatë fazës së ndërtimit, për të gjitha termat e mësipërme të Vendimit, subjekti është i detyruar të dorëzojë pranë AKM-se një relacion shkresorë në mënyrë periodike për mënyrën e zbatimit të kushteve (çdo 6-muaj).
- Bazuar në ligjin Nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar, subjekti të hartojë dhe një plan masash për ruajtjen e florës dhe faunës, duke ndaluar dëmtimin ose shkatërrimin e zonave të shumimit ose të vendeve të qëndrimit, për këto specie.

-Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	25.02.2023	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	25.02.2023	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	25.02.2023	Çdo 6 muaj

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedisi” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	25.02.2023	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	25.02.2023	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	25.02.2023	Çdo 6 muaj

- Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- Afati i Vlefshmërisë

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Konfirmoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Planvendosja e aktivitetit me koordinatat

Tabela 1 Koordinatat e Projektit, SistemiGauss Krueger dhe KRRGJSH

FID	X_KRRGJSH	Y_KRRGJSH	X_GAUSS	Y_GAUSS	Shpjegimi
1	452341.0996	4483402.513	4367548.253	4484502.389	Gardh me Bimë
2	452353.8313	4483383.545	4367560.772	4484483.274	Gardh me Bimë
3	452469.2314	4483461.083	4367677.067	4484559.515	Gardh me Bimë
4	452432.8229	4483515.269	4367641.268	4484614.121	Gardh me Bimë
5	452393.3618	4483452.832	4367601.093	4484552.122	Godina e Pompës
6	452400.4293	4483457.735	4367608.217	4484556.946	Godina e Pompës
7	452412.1174	4483440.888	4367619.716	4484539.964	Godina e Pompës
8	452405.0499	4483435.985	4367612.592	4484535.141	Godina e Pompës
9	452367.1935	4483548.061	4367576.001	4484647.662	Godina e Sistemit Zjarrfikës
10	452373.2455	4483552.146	4367582.1	4484651.679	Godina e Sistemit Zjarrfikës
11	452379.0089	4483543.607	4367587.767	4484643.073	Godina e Sistemit Zjarrfikës
12	452372.9569	4483539.522	4367581.668	4484639.056	Godina e Sistemit Zjarrfikës
13	452270.0263	4483481.022	4367478.06	4484581.715	Impianti Termik i Lëndueshëm
14	452290.111	4483494.956	4367498.306	4484595.424	Impianti Termik i Lëndueshëm
15	452336.0871	4483428.688	4367543.537	4484528.624	Impianti Termik i Lëndueshëm
16	452333.0384	4483413.478	4367540.315	4484513.447	Impianti Termik i Lëndueshëm
17	452316.0024	4483414.753	4367523.291	4484514.916	Impianti Termik i Lëndueshëm
18	452297.0422	4483499.765	4367505.292	4484600.154	Impianti Termik i Lëndueshëm
19	452317.1269	4483513.7	4367525.538	4484613.863	Impianti Termik i Lëndueshëm
20	452363.103	4483447.431	4367570.769	4484547.064	Impianti Termik i Lëndueshëm
21	452360.0542	4483432.221	4367567.547	4484531.886	Impianti Termik i Lëndueshëm
22	452343.0182	4483433.496	4367550.523	4484533.355	Impianti Termik i Lëndueshëm
23	452348.7961	4483434.156	4367556.31	4484533.95	Impianti Termik i Lëndueshëm
24	452397.5291	4483447.222	4367605.198	4484546.465	Kanali i marrjes së ujit të detit

25	452400.9071	4483442.254	4367608.52	4484541.457	Kanali i marrjes së ujit të detit
26	452155.339	4483282.581	4367361.107	4484384.546	Kanali i marrjes së ujit të detit
27	452161.6163	4483279.223	4367367.347	4484381.116	Kanali i marrjes së ujit të detit
28	452173.0275	4483256.515	4367378.503	4484358.276	Kanali i marrjes së ujit të detit
29	452176.1066	4483257.266	4367381.591	4484358.991	Kanali i marrjes së ujit të detit
30	452136.7565	4483196.904	4367341.551	4484299.068	Kanali i marrjes së ujit të detit
31	452139.505	4483195.7	4367344.286	4484297.832	Kanali i marrjes së ujit të detit
32	452402.5825	4483466.24	4367610.467	4484565.429	Kulla e TL për Linjën Ajrore
33	452473.7924	4483569.729	4367682.86	4484668.125	Kulla e TL për Linjën Ajrore
34	452376.0803	4483806.688	4367587.21	4484906.224	Kulla e TL për Linjën Ajrore
35	452359.7315	4483837.512	4367571.819	4484937.238	Linjë Nëntokësore
36	452356.8881	4483842.231	4367569.029	4484941.99	Linjë Nëntokësore
37	452350.3972	4483860.566	4367562.745	4484960.401	Linjë Nëntokësore
38	452358.9077	4483879.29	4367571.469	4484979.031	Linjë Nëntokësore
39	452298.3513	4483996.373	4367512.231	4485096.818	Linjë Nëntokësore
40	452307.7837	4484008.16	4367521.799	4485108.5	Linjë Nëntokësore
41	452245.0868	4484057.087	4367459.648	4485158.143	Linjë Nëntokësore
42	452301.6277	4484127.744	4367516.998	4485228.17	Linjë Nëntokësore
43	452224.2167	4484190.934	4367440.292	4485292.246	Linjë Nëntokësore
44	452194.3401	4484153.537	4367409.987	4485255.182	Linjë Nëntokësore
45	452402.4701	4483494.875	4367610.679	4484594.068	Pikë Kontrolli dhe Sigurie
46	452455.1491	4483530.27	4367663.767	4484628.872	Pikë Kontrolli dhe Sigurie
47	452418.2639	4483585.167	4367627.499	4484684.194	Pikë Kontrolli dhe Sigurie
48	452365.5867	4483549.768	4367574.413	4484649.388	Pikë Kontrolli dhe Sigurie
49	452319.7951	4483649.447	4367529.745	4484749.599	Rruga e Re
50	452325.3832	4483638.335	4367535.208	4484738.423	Rruga e Re
51	452378.805	4483558.654	4367587.734	4484658.124	Rruga e Re
52	452385.4144	4483563.095	4367594.395	4484662.491	Rruga e Re
53	452338.0528	4483634.406	4367547.835	4484734.35	Rruga e Re
54	452336.5288	4483688.905	4367546.929	4484788.873	Rruga e Re
55	452311.3109	4483727.779	4367522.148	4484828.038	Rruga e Re
56	452309.4637	4483737.373	4367520.409	4484837.655	Rruga e Re
57	452389.1146	4483792.887	4367600.7	4484892.274	Rruga e Re
58	452374.8154	4483540.425	4367583.537	4484639.939	Tubacion Nëntokësor
59	452392.4593	4483510.707	4367600.847	4484610.016	Tubacion Nëntokësor
60	452393.2803	4483513.066	4367601.695	4484612.366	Tubacion Nëntokësor
61	452403.5759	4483520.161	4367612.072	4484619.345	Tubacion Nëntokësor
62	452394.0516	4483534.273	4367602.706	4484633.567	Tubacion Nëntokësor
63	452396.5387	4483535.952	4367605.213	4484635.218	Tubacion Nëntokësor
64	452406.0631	4483521.84	4367614.579	4484620.996	Tubacion Nëntokësor
65	452415.1826	4483527.995	4367623.769	4484627.049	Tubacion Nëntokësor
66	452405.6583	4483542.107	4367614.404	4484641.27	Tubacion Nëntokësor
67	452408.1455	4483543.785	4367616.91	4484642.921	Tubacion Nëntokësor
68	452417.327	4483529.287	4367625.929	4484628.317	Tubacion Nëntokësor
69	452428.2319	4483513.13	4367636.652	4484612.034	Tubacion Nëntokësor
70	452426.5738	4483512.011	4367634.981	4484610.933	Tubacion Nëntokësor
71	452416.502	4483526.934	4367625.077	4484625.973	Tubacion Nëntokësor
72	452373.1573	4483539.306	4367581.866	4484638.838	Tubacion Nëntokësor

73	452427.4371	4483512.619	4367635.851	4484611.532	Tubacion Përcjellës
74	452460.6343	4483463.212	4367668.493	4484561.742	Tubacion Përcjellës
75	452359.6472	4483395.358	4367566.722	4484495.023	Tubacion Përcjellës
76	452347.254	4483413.803	4367554.537	4484513.611	Tubacion Përcjellës
77	452299.899	4483729.194	4367510.75	4484829.583	Zonë Parkimi për Kamionat
78	452319.1784	4483694.5	4367529.639	4484794.666	Zonë Parkimi për Kamionat
79	452373.6476	4483580.652	4367582.825	4484680.185	Zonë Parkimi për Kamionat
80	452337.6189	4483643.237	4367547.501	4484743.186	Zonë Parkimi për Kamionat
81	452387.0562	4483589.638	4367596.338	4484689.02	Zonë Parkimi për Kamionat
82	452357.3372	4483634.625	4367567.124	4484734.35	Zonë Parkimi për Kamionat
83	452356.9038	4483643.405	4367566.791	4484743.135	Zonë Parkimi për Kamionat
84	452305.8812	4483694.369	4367516.338	4484794.686	Zonë Parkimi për Kamionat
85	452283.2418	4483728.15	4367494.079	4484828.728	Zonë Parkimi për Kamionat
86	452291.8694	4483731.631	4367502.747	4484832.112	Zonë Parkimi për Kamionat
87	452318.5822	4483701.691	4367529.124	4484801.865	Zonë Parkimi për Kamionat



Figura 4 Planshtirje e funksionimit të Impiantit Termik Lëndueshëm me kapacitet 110 MWe në portin e Treporit në Vlorë, Shqipëri